



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 836 Prot.

Tiranë, më datë 08.07.2021

**VENDIM**  
**Nr. 329, datë 07.07.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.07.2021:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e relacionit të konstatimeve në terren më datë 18.06.2021, për strukturat e mureve të zbuluara gjatë zbatimit të Projektit “Ndërtimi i parkingut dhe rehabilitimi i sheshit Çerciz Topulli”, Zona Historike Gjirokastrë, realizuar nga DRTK Gjirokastrë dhe IKTK;
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin “Dizenjimi për Rivitalizimin e sheshit “Çerciz Topulli” dhe Parkim nëntokësor në Pazarin e Vjetër të Gjirokastrës”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Pas zbulimit të plotë të strukturës së murit të evidentuar gjatë punimeve, subjekti i licencuar në arkeologji duhet të përgatisë një raport të detajuar, i cili do të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
Arta DOLLANI

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**

